

Z. Ervin Koçi mban detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës Financiare prej Shtator 2022.

Z. Koçi u diplomua në vitin 1997 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, në degën Administrim Biznesi. Më pas u diplomua me titullin “Jurist” në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Në vitin 2004 ka ndjekur studimet Master në degën Administrim Publik, Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik në bashkëpunim me Universitetin e Nebraskës, Lincoln, SHBA, si dhe mban titullin “Doktor i Shkencave”, titull i fituar me mbrojtjen e temës lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Gjatë karrierës së tij ka mbajtur funksione të tjera rëndësishme si Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Anëtar Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për periudhën 2017-2020 si dhe ka qenë anëtar i Parlamentit për periudhën 2009-2017. Gjithashtu Z. Koçi, ka mbajtur një sërë funksionesh të tjera lidhur me fushën bankare, fiskale dhe në administrimin e shoqërive publike dhe tregtare, si dhe ka qenë i angazhuar si lektor i jashtëm në Universitetin Publik “Ismail Qemali”, Vlorë, për një periudhë të gjatë kohore.

Po ashtu, Z. Koçi është bashkëautor i një sërë publikimesh me interes në fushën e ekonomisë dhe financave.